

Vendim nr. 12 datë 15.03.2023

(V-12/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.03.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (I) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: IDRIZ KONJARI

SUBJEKT I INTERESUAR:

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

**OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.05.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 124, 131, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141, 142 dhe 167 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjekti i interesuar, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Idriz Konjari, me urdhrin nr. 908, datë 01.11.2006 të ministrit të Punëve të Jashtme (sot ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme), ka fituar gradën diplomatike “sekretar i parë”. Në vijim, me urdhrin nr. 40, datë 11.02.2011 të ministrit të MEPJ-së, është emëruar i ngarkuar me punë pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kuala Lumpur, Malajzi. Në bazë të këtij urdhri, marrëdhëniet me detyrën dhe ato financiare ishin sipas gradës diplomatike “ministër këshilltar” dhe fillonin në datën e paraqitjes në përfaqësi.

2. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 510, datë 30.07.2014, ka vendosur mbylljen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Malajzisë, Kuala Lumpur, për pasojë kërkuesi, me urdhrin nr. 379, datë 22.10.2014, është liruar nga detyra.

3. Ai ka ngritur padi në gjykatë me objekt kthimin në vendin e punës në përputhje me gradën diplomatike “sekretar i parë”, dhënien e pagës nga momenti i shkëputjes deri në kthimin në vendin e punës, si dhe dëmshpërblimin me pagën e 18 muajve, në aplikim të neneve 143, 144, 145 dhe 155, pika 3, të Kodit të Punës.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 691, datë 16.02.2015, e ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke detyruar Ministrinë e Punëve të Jashtme (sot Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme) t'i paguajë 15 paga mujore dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës dhe afatit në zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe duke caktuar afatin 2-vjeçar për ekzekutimin e detyrimit nga marrja formë të prerë të vendimit. Masa e dëmshpërblimit është referuar te paga mujore e kërkuesit, por pa përcaktuar masën konkrete të saj dhe nëse ajo ishte bruto ose neto. Gjykata Administrative e Apelit, pas shqyrtimit të ankimit të MEPJ-së, me vendimin nr. 3575(86-2017-3736), datë 24.07.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs.

5. Në vijim, sipas urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata, kërkuesi i është drejtuar përmbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv - vendimit gjyqësor. Në kuadër të vënies në ekzekutim të vendimit, në datën 09.10.2017 përmbaruesi gjyqësor ka lajmëruar me shkrim palën debitore, MEPJ-në, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit në favor të kërkuesit kreditor brenda afatit 5-ditor, duke i njoftuar edhe masën e detyrimit në vlerën 33,975 dollarë amerikanë (USD) ose 3,884,362 lekë (shumë e konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë), e cila do të ndahej në 6 kështe të barabarta brenda dy vjetësh. Vlera ka rezultuar nga llogaritja e dëmshpërblimit në masën e 15 pagave mujore, bazuar në vërtetimin e

datës 25.11.2014, të paraqitur nga debitori, sipas të cilit kërkuksi në periudhën 22.03.2011 - 22.10.2014 ishte paguar me pagë mujore në vlerën 2,265 USD, që përkon me pozicionin e punës “i ngarkuar me punë në ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Malajzi”.

6. Nëpërmjet urdhërshirimit nr. 247, datë 12.04.2018, pala debitore, MEPJ-ja, ka kaluar në llogari të përmbaruesit gjyqësor shumën 1,602,720 lekë dhe nuk rezulton që ajo të ketë kryer veprime të mëtejshme në kuadër të ekzekutimit të titullit ekzekutiv në masën e plotë të detyrimit të përcaktuar në lajmërimin për ekzekutimin vullnetar, pasi e ka vlerësuar të përmbushur detyrimin. Pavarësisht qëndrimit të MEPJ-së, ekzekutimi nuk është pushuar nga përmbaruesi gjyqësor, i cili, me shkresat e datës 16.04.2018 dhe 09.05.2019, ka bërë me dije palën debitore se kishte bërë likuidim të pjesshëm të shumës. Gjithashtu, përmbaruesi gjyqësor ka njoftuar MEPJ-në se detyrimi i mbetur për t’u përmbushur ishte në vlerën 2,654,541 lekë.

7. Në datën 14.07.2020 kërkuksi ka paraqitur kërkesë në gjykatë me pretendimin se detyrimi sipas titullit ekzekutiv nuk ishte përmbushur plotësisht nga debitori, për sa i përket vlerës 2,654,541 lekë, për shkak se vendimi gjyqësor nuk ishte i qartë lidhur me masën e dëmshpërblimit me referencë te paga mujore. Sipas tij, vendimi gjyqësor nuk identifikonte pagën mujore sipas pozicionit të punës dhe nëse paga ishte bruto ose neto. Konkretisht, kërkuksi, bazuar në nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka kërkuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 691, datë 16.02.2015, të lënë në fuqi me vendimin nr. 3575(86-2017-3736), datë 24.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kërkesa është pranuar me vendimin e datës 01.10.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka sqaruar se: (i) pozicioni i punës, paga e të cilit do të shërbejë për llogaritjen e vlerës totale të dëmshpërblimit të dhënë nga gjykata në favor të kërkuksit është “*i ngarkuar me punë në ambasadën tonë në Malajzi, ku është paguar me pagë mujore 2,265 (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) dollarë*”; (ii) paga mbi të cilën llogaritet dëmshpërblimi është paga “*bruto*”.

8. Subjekti i interesuar, MEPJ-ja, ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 108(86-2021-766), datë 20.12.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 314 i KPC-së, pasi kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj edhe nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv është ekzekutuar ose jo plotësisht apo nëse përmbaruesi ka vendosur ose jo pushimin e ekzekutimit. Pavarësisht kësaj, gjykata e apelit është shprehur edhe për themelin e kërkesës, duke arsyetuar se referenca e pagës për llogaritjen e dëmshpërblimit ishte

ajo e caktuar nga ministri përgjegjës dhe Këshilli i Ministrave, sipas gradës diplomatike dhe jo paga e pozicionit të fundit të punës të mbajtur nga kërkuesi.

9. Kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke pretenduar se: (i) vendimi bie ndesh me nenin 314 të KPC-së, me Kodin e Punës, me ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe atë për shërbimin e jashtëm, si dhe me praktikën e Gjykatës së Lartë për llogaritjen e dëmshpërblimit në rastin e zgjidhjes së paligjshme të marrëdhënies së punës; (ii) qëndrimi i gjykatës së apelit se kërkesat për sqarim dhe interpretim vendimi duhet të bëhen përpara se të nisë procedura e ekzekutimit, bie në kundërshtim të hapur me nenin 314 të KPC-së; (iii) ekzekutimi përfundon vetëm me vendimin përkatës të përmbaruesit gjyqësor dhe në rastin konkret MEPJ-ja nuk e ka shlyer pjesën e mbetur të detyrimit prej 2,654,541 lekësh; (iv) qëndrimi i gjykatës së apelit ka zvogëluar debinë e MEPJ-së, duke zëvendësuar mjetin e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore që ligji u ka dhënë palëve në një procedurë ekzekutimi; (v) gjykata e apelit, ndonëse ka arsyetuar për kohën e ngritjes së kërkesës, në vijim e ka interpretuar ligjin me njëanshmëri, duke vendosur në kundërshti me të; (vi) gjykata e apelit, në kundërshtim me ligjin, është shprehur se paga për dëmshpërblim është vetëm paga bazë për gradë dhe ka reduktuar elementet përbërëse të pagës së kërkuesit; (vii) gjykata e apelit ka anashkaluar përllogaritjen e dëmshpërblimit nga përmbaruesi gjyqësor, bazuar në pagën e fundit të kërkuesit, që është vënë në dispozicion nga vetë MEPJ-ja, e cila nuk ka ngritur asnjë kundërshtim sipas neneve 610 e vijues të KPC-së; (viii) gjykata e apelit, pavarësisht se shprehet që nuk mund të bëhet kërkesa për sqarim dhe interpretim vendimi, në vijim ka bërë sqarimin e tij; (ix) vendimi është në kundërshtim me praktikën gjyqësore, pasi nuk ka referenca ligjore dhe në kundërshtim me ligjet për shërbimin e jashtëm dhe Kodin e Punës, për përcaktimin e pagës referuese për llogaritjen e dëmshpërblimit për rastin e largimit të padrejtë nga puna.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-883, datë 13.05.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

11. Në datën 06.09.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në atë gjykatë. Kolegji i Gjykatës në datën 18.11.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pretendimet e tij në rekurs mbi shkeljet e rënda të ligjit nga gjykata e apelit. Mënyra e interpretimit të nenit 314 të KPC-së e ka vënë kërkuesin në pamundësi të përdorë mjetin procedural të garantuar nga ligji për mbrojtjen e të drejtave të tij.

12.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë janë parashtruar kërkimet dhe argumentet e kërkuesit për zbatimin e gabuar të ligjit, por nuk janë dhënë arsye përse ato nuk përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Vendimi i kundërshtuar është formal dhe nuk përllig qëndrimin e mbajtur. Gjykata e Lartë kishte detyrimin për arsyetim, në kushtet kur vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, është bazuar në norma që nuk ekzistojnë dhe ka ndryshuar vendimin gjyqësor të formës së prerë që kishte zgjidhur themelin e çështjes së kërkuesit.

12.3. *Së drejtës së ankimit*, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë duhet ta zgjidhte çështjen me arsyetim në kushtet kur gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta. Për këtë shkak, kërkuesit i është shkelur edhe e drejta e aksesit substancial në gjykatë nëpërmjet ankimit.

13. **Subjekti i interesuar**, MEPJ-ja, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të

drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individ i duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 8, datë 03.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues me objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit që kishte vendosur rrëzimin e kërkesës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, me qëllim saktësimin e masës së dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Për nga natyra dhe qëllimi, ky lloj vendimi i bashkohet si pjesë përbërëse vendimit përfundimtar që ka disponuar për të drejtën e dëmshpërblimit financiar nga zgjidhja e marrëdhënies së punës. Për rrjedhojë, në kushtet kur procesi gjyqësor ka përfunduar dhe kërkuesi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, Gjykata çmon se ai e ka përmbushur këtë kriter, pasi nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, të pretenduara si të cenuara.

18. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.05.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 06.09.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi parashtroi se me vendimin e mospranimit të rekursit, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se gjykata e apelit e kishte rrëzuar kërkesën për saktësimin e vendimit gjyqësor, për shkak të interpretimit të gabuar dhe diametralisht të kundërt të ligjit në raport me interpretimin e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje as pretendimit për kontradiktoritetin e vendimit të gjykatës së apelit. Si rrjedhojë e këtyre shkeljeve, sipas kërkesit, masa e dëmshpërblimit e fituar

prej tij me vendim gjyqësor të formës së prerë është ndryshuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk e ka riparuar këtë cenim. Mbi bazën e këtyre fakteve, kërkuesi pretendon se atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektin e aksesit, standardit të arsyetimit dhe ankimit substancial, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 142, pika 1 dhe 43 të Kushtetutës, të cilat hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës.

20. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se standardet e procesit të rregullt ligjor janë ngushtësisht të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi edhe i vetëm njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 86, datë 26.12.2017; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se pretendimet lidhen me mënyrën e argumentimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të kërkuesit, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

22. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje se përse pretendimet e tij nuk përfshiheshin në kategorinë e rasteve të përcaktuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Ajo gjykatë nuk ka riparuar arsyetimin kontradiktor të vendimit të gjykatës së apelit, i cili është bazuar në norma që nuk ekzistojnë dhe ka ndryshuar vendimin gjyqësor të formës së prerë që kishte zgjidhur themelin e çështjes. Si rrjedhojë, është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi është mbajtur qëndrim formal. Kjo mënyrë e ushtrimit të rolit të Gjykatës së Lartë, në kushtet kur dy gjykatat më të ulëta kishin dhënë vendime diametralisht të kundërta, i ka cenuar kërkuesit edhe të drejtën e ankimit në aspekt të aksesit substancial në gjykatë. Sipas tij, Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për akses edhe për shkak se nuk është shprehur për pretendimet në rekurs mbi shkeljet e rënda të ligjit material dhe procedural të gjykatës së apelit, duke i kufizuar aplikimin e nenit 314 të KPC-së dhe duke e vendosur në pamundësi për të ezauruar mjetin mbrojtës procedural të garantuar nga ligji.

23. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka

të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

24. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuarit ka natyrë kushtetuese, pasi, në thelb, lidhet me të drejtën e dëmshpërblimit si rrjedhojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, e drejtë e cila është fituar prej tij me vendim gjyqësor përfundimtar. Këtij pretendimi, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme, duke interpretuar dhe zbatuar në mënyrë diametralisht të kundërt nenin 314 të KPC-së, sipas të cilit gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar.

27. Kështu, konkretisht, gjykata e shkallës së parë e ka pranuar kërkesën për sqarim dhe interpretim, duke cilësuar edhe vlerën e pagës mbi të cilën do të duhej të bëhej ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, që do të thotë se ajo gjykatë ka vlerësuar se një kërkesë e tillë, sipas nenit 314 të KPC-së, mund të ngrihet në gjykatë edhe kur ekzekutimi është në vijim e sipër. Ndërsa, gjykata e apelit e ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se neni 314 i KPC-së, në thelb, përcakton se kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor) është ekzekutuar ose jo plotësisht. Sipas saj, në fazën e ekzekutimit, legjislacioni procedural parashikon mjete të tjera që mund të përdoren nga palët e interesuara. Në vijim, gjykata e apelit, ndonëse ka konstatuar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga ligji, ka vijuar me analizimin e pretendimit të kërkuarit për pagën referuese të dëmshpërblimit, duke e përcaktuar atë sipas gradës diplomatike dhe jo sipas pozicionit të fundit të punës së kërkuarit.

28. Ndërkohë, Gjkata e Lartë, në vendimin e mospranimit të rekursit, ka parashtruar rrethanat dhe faktet e çështjes, si dhe ka listuar pretendimet e kërkuarit në rekurs, pjesa më e madhe e të cilave lidhet me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të nenit 314 të KPC-së. Arsyetimi i këtij vendimi është i kufizuar, duke u mjaftuar me qëndrimin se përfundimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

29. Gjkata vëren se Gjkata e Lartë, ndonëse gjendej përpara interpretimit diametralisht të kundërt të ligjit prej dy gjykatave më të ulëta, nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuarit. Për më tepër, arsyetimi i gjykatës së apelit se kërkesa të tilla nuk mund të ngrihen nëse ekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka filluar, bie ndesh në pamje të parë me vetë formulimin ligjor të nenit 314 të KPC-së, i cili parashikon shprehimisht si kufi kohor “*gjersa vendimi nuk është ekzekutuar*”. Nga mënyra se si Gjkata Administrative e Apelit ka interpretuar këtë dispozitë ligjore, duket sikur mjafton që ekzekutimi të ketë filluar, pavarësisht masës së përmbushjes së detyrimit, qoftë edhe të pjesshme, që vendimi të konsiderohet i ekzekutuar. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit në raport me rrethanat dhe faktet e rastit konkret, në dukje është e paarsyeshme, duke mbajtur në konsideratë se kërkuari i ishte drejtuar rrugës gjyqësore për mbrojtjen e një të drejte, të fituar gjyqësisht dhe ku vendimi gjyqësor që ia njihte atë lexohej në mënyra të ndryshme prej tij e përmbartuesit gjyqësor, nga njëra anë, dhe MEPJ-së, në cilësinë e debitorit, nga ana tjetër. Po ashtu, Gjkata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit për kontradiktën në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit në drejtim të shkaqeve të rrëzimit të kërkesës, pasi ndonëse është konkluduar se kërkesa për sqarim

është paraqitur jashtë afatit ligjor, ndaj nuk mund të shqyrtohej në themel, në vijim është mbajtur qëndrim mbi themelin e kërkesës për përcaktimin e pagës referuese të dëmshpërblimit.

30. Nën dritën e analizës së mësipërme, Gjykata ripohon rolin e Gjykatës së Lartë, e cila si gjykatë e ligjit i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të ushtruar rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 42, datë 07.07.2014; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit, të lidhur me aksesin dhe ankimin substancial, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues i kërkuarit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.05.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.03.2023

Shpallur më 12.04.2023

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Idriz Konjari dhe objekt “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.05.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën*”, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ndaj çmojmë të shprehemi në mendim pakice për sa vijon.

2. Në mënyrë të përmbledhur, vlerësojmë se mënyra e arsytimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë në kundërshtim me standardet kushtetuese të të drejtave themelore të njeriut për këto arsye kryesore:

2.1. *Së pari*, gjykatat e sipërpërmendura lidhur me diskutimin mbi kufijtë e zbatimit të mjetit procedural të parashikuar nga neni 314 të KPC-së (kërkesë për sqarim dhe interpretim të vendimit gjyqësor), u kanë dhënë përgjigje në mënyrë të qartë dhe shteruese pretendimeve të kërkuesit.

2.2. *Së dyti*, zbatimi i nenit 314 të KPC-së është natyralisht juridiksion i gjykatave të zakonshme, dhe mënyra se si ato e kanë interpretuar këtë dispozitë nuk arrin të provojë arbitraritet me pasoja antikushtetuese për të drejtat themelore të kërkuesit.

2.3. *Së treti*, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e së drejtës substanciale të pronës, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që caktonte në dispozitiv detyrimin e pagesës së 15 pagave mujore dëmshpërblim për kërkuesin nga MEPJ-ja.

3. Konkretisht, shumica ka argumentuar: “Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit ka natyrë kushtetuese, pasi në thelb lidhet me të drejtën e dëmshpërblimit si rrjedhojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, e drejtë e cila është fituar prej tij me vendim gjyqësor përfundimtar. Këtij pretendimi, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme, duke interpretuar dhe zbatuar në mënyrë diametralisht të kundërt nenin 314 të KPC-së, sipas të cilit gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar.” (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Po ashtu shumica analizon se “[...] Gjykata e Lartë, ndonëse gjendej përpara interpretimit diametralisht të kundërt të ligjit prej dy gjykatave më të ulëta, nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Për më tepër, arsytimi i gjykatës së apelit se kërkesa të tilla nuk mund të ngrihen nëse ekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka filluar, bie ndesh në pamje të parë me vetë formulimin ligjor të nenit 314 të KPC-së, i cili

parashikon shprehimisht si kufi kohor “*gjersa vendimi nuk është ekzekutuar*”. Nga mënyra se si Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar këtë dispozitë ligjore, duket sikur mjafton që ekzekutimi të ketë filluar, pavarësisht masës së përmbushjes së detyrimit, qoftë edhe të pjesshme, që vendimi të konsiderohet i ekzekutuar. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit në raport me rrethanat dhe faktet e rastit konkret, në dukje është e paarsyeshme, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi i ishte drejtuar rrugës gjyqësore për mbrojtjen e një të drejte, të fituar gjyqësisht dhe ku vendimi gjyqësor që ia njihte atë lexohej në mënyra të ndryshme prej tij e përmbaruesit gjyqësor, nga njëra anë, dhe MEPJ-së, në cilësinë e debitorit, nga ana tjetër. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje as pretendimit të kërkuesit për kontradiktën në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit në drejtim të shkaqeve të rrëzimit të kërkesës, pasi ndonëse është konkluduar se kërkesa për sqarim është paraqitur jashtë afatit ligjor, në vijim është mbajtur qëndrim mbi themelin e kërkesës për përcaktimin e pagës referuese të dëmshpërblimit” (shih *paragrafin 29 të vendimit*).

4. Gjykata, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës. Sipas kësaj jurisprudence, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të

drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2 datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 6, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë vetëm duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin konkret rezulton se me vendimin nr. 691, datë 16.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është pranuar pjesërisht padia e kërkuarit, duke u detyruar pala e paditur, Ministria e Punëve të Jashtme, t'i paguajë 15 paga mujore dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës dhe afatit në zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe kërkuari ka vënë në lëvizje procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, vendimit gjyqësor. Në datën 09.10.2017 përmbartuesi gjyqësor ka lajmëruar me shkrim MEPJ-në për ekzekutimin vullnetar të detyrimit në favor të kërkuarit kreditor brenda afatit 5-ditor, duke i njoftuar shumën e detyrimit në vlerën 3,884,362 lekë, pas llogaritjes së 15 pagave mujore me vlerë 2,265 USD, të konvertuar në lekë. Sipas kërkuarit, MEPJ-ja, nëpërmjet urdhërshirimit nr. 247, datë 12.04.2018, ka kaluar shumën prej 1.602.720 lekësh, duke lënë të paekzekutuar pjesën tjetër të detyrimit në vlerën 2,654,541 lekë (*shih paragrafët 4-6 të vendimit*).

7. Duke pretenduar se vendimi gjyqësor nuk ishte i qartë lidhur me shumën e dëmshpërblimit, pasi nuk identifikohet paga mujore sipas pozicionit të punës dhe as nëse paga ishte bruto ose neto, kërkuari i është drejtuar gjykatës me kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e tij. Me vendimin e datës 01.10.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar kërkesën dhe ka sqaruar se: (i) pozicioni i punës, paga e të cilit do të shërbejë për llogaritjen e vlerës totale të dëmshpërblimit të dhënë nga gjykata në favor të kërkuarit është “*i ngarkuar me punë në ambasadën tonë në Malajzi, ku është paguar me pagë mujore 2,265 (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) dollarë*”; (ii) paga mbi të cilën llogaritet dëmshpërblimi është paga “*bruto*”. Mbi bazën e ankimit të palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 108 (86-2021-766), datë 20.12.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 314 i KPC-së, duke u shprehur gjithashtu se referenca e pagës për llogaritjen e dëmshpërblimit ishte ajo e caktuar nga ministri përgjegjës dhe Këshilli i Ministrave sipas gradës diplomatike dhe jo paga e pozicionit të fundit të punës të mbajtur nga kërkuari. Mbi bazën e rekursit të ushtruar nga kërkuari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-883, datë

13.05.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 (*shih paragrafët 7-10 të vendimit*).

8. Sikundër theksuam edhe më lart, në vlerësimin tonë kërkuesi nuk ka provuar cenimin e së drejtës kushtetuese të pronës, që synon të mbrojë nëpërmjet këtij ankimi kushtetues dhe as shumica nuk ka arritur të përcaktojë një të drejtë të tillë. Siç rezulton nga faktet, kërkuesi, me vendim të formës së prerë, ka fituar dëmshpërblimin për zgjidhjen e kontratës së tij të punës në mënyrë të paligjshme. Sipas këtij vendimi gjyqësor, masa e dëmshpërblimit është përcaktuar në masën e 15 pagave dhe jo në vlerë monetare. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se thjesht pritshmëritë e ligjshme dhe fitimet ose pasuritë e ardhshme sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së nuk mund të mbrohen nëse nuk gjejnë mbështetje, për shembull, me vendim gjyqësor të ekzekutueshëm. Kështu, pasuri në kuptimin e pronës do të kuptohet vetëm ajo që është përcaktuar me një vendim gjyqësor përfundimtar (*shih vendimin Pressos Compania Naviera S.a. e të tjerë kundër Belgjikës, (1995), prg.29-31*). Po ashtu, sipas kësaj gjykate, nga ana tjetër, kërkuesi nuk mund të pretendojë se ka një pritshmëri të ligjshme në rastin kur është vënë në diskutim interpretimi dhe zbatimi i saktë i së drejtës kombëtare dhe pretendimet e tij janë rrëzuar nga gjykatat kombëtare (*Anheuser-Busch Inc. v. Portugal [GC], § 65; Centro Europa 7 S.R.L. and di Stefano v. Italy [GC], § 173; Béláné Nagy v. Hungary [GC], § 75; Karachalios v. Greece (dec.), § 46; Radomilja and Others v. Croatia [GC], § 149*).

9. Në analizë të sa më lart, e drejta e pronësisë së kërkuetit është ajo që ka buruar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, i vënë në ekzekutim me anë të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, pra 15 pagat mujore, ndërkohë që e drejta e pretenduar nga kërkuesi, për një detyrim në vlerën 2,654,541 lekë, nuk përbën një të drejtë pronësore të matshme në kuptimin kushtetues, por një pritshmëri, të pretenduar si diferencë mes vlerës së detyrimit të paguar nga debitori dhe asaj që, sipas kërkuetit, është vlera e 15 pagave që i takojnë.

10. Shumica, duke e lidhur kërkesën e paraqitur në kuptim të nenit 314 të KPC-së me përcaktimin detyrues të vendimeve gjyqësore që kanë gjykuar në themel çështjen, ka vënë në dyshim vlerën përfundimtare të atij gjykimi dhe natyrën e tij *res judicata* në lidhje me të drejtën e pronës së kërkuetit. Në vlerësimin tonë, në kushtet kur nuk është vënë në diskutim nga palët në proces masa e detyrimit të përcaktuar nga gjykata, ajo prej 15 pagash, ose fuqia detyruese e atij vendimi, pretendimet në lidhje me mënyrën se si është përlllogaritur vlera që i korrespondon këtyre pagave apo çdo pretendim i lindur gjatë procedurës përmbartimore, duhet të zgjidheshin me anë të mjeteve të ankimit që parashikon legjislacioni procedural.

11. Për sa i përket kërkesës sipas nenit 314 të KPC-së, gjykata e shkallës së parë e ka pranuar kërkesën për sqarim dhe interpretim, duke cilësuar edhe vlerën e pagës mbi të cilën do të duhet të bëhet ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, ndërsa gjykata e apelit e ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se neni 314 i KPC-së, në thelb, përcakton se kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor) është ekzekutuar ose jo plotësisht. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se përfundimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

13. Duke iu referuar vendimeve në fjalë konstatohet se gjykata e apelit ka argumentuar qëllimin e nenit 314 të KPC-së dhe kushtet që duhet të plotësohen për përdorimin e këtij mjeti procedural, duke vlerësuar se: “[...] ky mjet ka për qëllim të sqarohen dhe interpretohen vetëm ato pjesë të arsyetimit të vendimit mbi faktin dhe ligjin të cilat nga ana e kërkuesit pretendohet se nuk janë ezaauruese, në kuptimin që janë dukshëm të errëta, të paqarta apo kontradiktore aspektet të caktuara të vlerësimit dhe arsyetimit të gjykatës për zgjidhjen e çështjes në lidhje me ndonjërin nga kërkimet e padisë objekt gjykimi dhe veçanërisht në krahasim me atë që ka vendosur gjykata në dispozitivi e saj për zgjidhjen e çështjes” (shih paragrafin 31 të vendimit të gjykatës së apelit).

14. Gjykata e apelit e ka vazhduar arsyetimin, duke u shprehur se ky mjet nuk ka për qëllim të ndryshojë disponimin e gjykatës në lidhje me zgjidhjen e çështjes, i cili tashmë përbën *res judicata*, çka nënkupton se çdo pretendim në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes ose refuzimin e palëve për zbatimin e vendimit, duhet të zgjidhet me mjetet ligjore përkatëse. Referuar nenit 314 të KPC-së, ndreqja e gabimit është përcaktuar në mënyrë të qartë se bëhet për sa kohë që vendimi nuk është ekzekutuar, pasi nënkupton se gjatë kësaj procedure ka pasur paqartësi në lidhje me mënyrën/formën apo ekzekutimin. Pra, kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që përbën tashmë titull ekzekutiv, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse ky titull është ekzekutuar ose jo plotësisht apo nëse përmbartuesi ka vendosur ose jo pushimin e ekzekutimit (shih paragrafin 33 të vendimit të gjykatës së apelit). Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, Gjykata e Lartë, gjithashtu, ka qartësuar se “në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore vlerësohet se përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural” (shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

15. Për sa më lart, gjykata e apelit, në ushtrimin e funksionit të saj për të kontrolluar vendimmarrjen e gjykatës më të ulët dhe për të interpretuar normën e zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, ka paraqitur argumente të mjaftueshme, të qarta dhe shteruese në lidhje

me përfundimin e arritur prej saj. Ajo ka vlerësuar në vendim çështjet e faktit dhe të ligjit që kanë rezultuar në rastin konkret, duke përcaktuar momentin dhe kufijtë e zbatueshmërisë së mjetit të parashikuar nga neni 314 i KPC-së. Në të kundërt me qëndrimin e shumicës, sipas së cilës interpretimi i kësaj dispozite nga Gjykata Administrative e Apelit në dukje është i paarsyeshëm, ne vlerësojmë se interpretimi i kësaj gjykate, sipas të cilit kërkesa për interpretim mund të ngrihet para se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor) është ekzekutuar ose jo, i mbështetur edhe nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë, nuk është i natyrës kushtetuese, por i natyrës ligjore, dhe si i tillë përbën element që ndan juridiksionin kushtetues nga juridiksioni i gjyqësorit të zakonshëm, ndaj nuk duhej të analizohej nga shumica.

16. Përveç sa më lart, edhe pse nuk vëmë në dyshim jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me rastet kur për shkak të qëndrimeve diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit dhe mungesës së ndërhyrjes së Gjykatës së Lartë janë vënë në dyshim të drejtat themelore të individit, vlerësojmë se kjo qasje ka qenë e kufizuar dhe e kujdesshme pa dashur dhe pa synuar të zhveshë nga roli i saj Gjykatën e Lartë. Megjithatë, në rastin konkret Gjykata e Lartë, për sa kohë e ka gjetur të bazuar vendimin e gjykatës së apelit, duke e shprehur në mënyrë të qartë këtë qëndrim, kjo nënkupton se ajo ka vlerësuar të drejtë qëndrimin dhe mënyrën e zbatimit të ligjit prej gjykatës më të ulët.

17. Po ashtu, edhe argumenti tjetër i shumicës se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për kontradiktën në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit në drejtim të shkaqeve të rrëzimit të kërkesës, pasi ndonëse është konkluduar se kërkesa për sqarim është paraqitur jashtë afatit ligjor, në vijim është mbajtur qëndrim mbi themelin e kërkesës për përcaktimin e pagës referuese të dëmshpërblimit, nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit objekt kundërshtimi. Kjo pasi linja e arsyetimit dhe interpretimit të gjykatës së apelit harmonizohet me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke i dhënë kërkuarit përgjigje ezauruese në lidhje me mjetin e përdorur prej tij.

18. Për më tepër, duke iu referuar këtij arsyetimi, rezulton se gjykata e apelit ka vlerësuar se “[...] në shërbimin diplomatik ligji i zbatueshëm i kohës përcakton qartë në nenin 39, shkronja “dh”, se nëpunësi i shërbimit të jashtëm përfiton trajtim financiar të posaçëm në përputhje me statusin e tij. Kjo dispozitë, e zbërthyer në qëllimin dhe përmbajtjen e tij në aktet nënligjore, synon të përcaktojë se paga e nëpunësit të shërbimit diplomatik përcaktohet nga grada diplomatike që ai gëzon... Paga, sipas gradës diplomatike, caktohet nga Këshilli i Ministrave dhe individualisht nga ministri përgjegjës për punët e jashtme. Ndërsa në rastin, dhe vetëm për kohën kur diplomati ushtron detyrën në misionë diplomatike e konsullore jashtë vendit, krahas pagës sipas gradës

diplomatiqe përfiton edhe shtesë page bazuar në indekset e nivelit të jetesës së vendit pritës dhe kategorizimit të këtyre vendeve. Ky lloj trajtimi financiar gjen zbatim për aq kohë sa diplomati ushtron detyrën në këto misione diplomatike, duke përfituar kështu vetëm trajtimin financiar dhe pagën sipas gradës diplomatike kurdoherë që përfundon apo ndërpritet emërimi në misionet diplomatike e konsullore jashtë vendit.” (shih paragrafin 34 të vendimit të gjykatës së apelit). Ky arsyetim i saj nuk shfaq kontradikta me pjesën tjetër të vendimit, përkundrazi është argument shtesë dhe rrjedhë logjike e vendimit, i parë në tërësinë e tij.

19. Në përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj Gjykate dhe fakteve të natyrës kushtetuese, vlerësojmë se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Genti Ibrahimi